



Prishtinë, më 1 Dhjetor 2016

MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT

Në mes të:

1. Kosovo United States Alumni (KUSA), e përfaqësuar nga Rozafa Ukimeraj në njërën anë:

dhe
2. Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan, i përfaqësuar nga Rektori, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, në anën tjetër.

Palët pajtohen me sa vijon:

Neni 1 Qëllimi i Bashkëpunimit

KUSA dhe Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan dakordohen të bashkëpunojnë sa i përket implementimit të programit të "Mentorimit të Gjeneratave", me qëllim të rritjes së rolit të femrave studente dhe përgatitja e tyre në involvimin e tyre në jetën shoqërore dhe institucionale pas përfundimit të studimeve.

Neni 2 Obligimet e Universitetit

Universiteti obligohet që listën prej 8 studenteve t'a dërgojë tek KUSA si dhe të sigurojë transportin për studentet pjesëmarrëse në program.

Neni 3 Obligimet e KUSA-s

1. KUSA obligohet që për secilën studente të gjejë një mentore femër, e cila do të realizojë programin e mentorimit për secilën studente veç e veç;
2. KUSA do të organizojë ngjarjen lansuese të programit; do të kontribuojë në implementimin e programit si dhe do të organizon ngjarjen përmbyllëse të programit.

Neni 4 Kohëzgjatja

Programi i mentorimit zgjatë tre muaj, sipas një orari të përcaktuar me marrëveshje ndërmjet mentoreve dhe studenteve.

Neni 5 Standardi i Punës

KUSA dhe Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan dakordohen që implementimi i programit, të bëhet sipas standardeve më të larta të etikës profesionale.

Neni 6 Përfundimi dhe vlerësimi


Pas përfundimit të programit, KUSA do të lëshojë certifikata të pjesëmarrjes në program për studentet që kanë vijuar programin, ndërsa Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan do të lëshojë një referencë lidhur me vlerësimin e angazhimit dhe për përfitimet e dyanshme të studenteve.

Neni 7 Zgjidhja e Marrëveshjes



Çfarëdo konflikti që rrjedhe nga kjo marrëveshje mund të zgjidhet me pajtim ose në përputhje me rregullat e Legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Marrëveshja lidhet në tre ekzemplarë identikë, nga një për secilën pale dhe një për arkivin e KUSA.

Palët nënshkruese



Rozafa Ukimeraj
Koordinatorë e Programit të Mentorimit
Kosovo United States Alumni



Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi
Rektor,
Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan